

Thirrje e hapur për Artist/e të Muraleve!

Rreth SIT: SIT - Qendra për Këshillim, Shërbime Sociale dhe Hulumtime është një organizatë joqeveritare misioni i të cilës është promovimi dhe krijimi i një shoqërie të barabartë për të gjithë. Kështu, ne trajtojmë disa nga çështjet më sfiduese të të drejtave të njeriut në komunitetin tonë që na pengojnë të arrijmë barazi, paqe dhe zhvillim - duke përfshirë dhunën në familje dhe dhunën me bazë gjinore. Organizata është themeluar për të shërbyer në tre (3) departamente: si qendër për këshillim e cila ofron shërbime identifikimi dhe këshillimi për individët ose grupet që kanë nevojë për parandalimin e dhunës së bazuar në gjini dhe dhunën në familje, rehabilitimin dhe riintegrimin e dhunuesve; një qendër që promovon të drejtat e njeriut, barazinë gjinore, parandalimin e dhunës, dhunës me bazë gjinore dhe dhunës në familje, promovon një mënyrë jetese të shëndetshme tek të rinjtë, promovon shëndetin seksual dhe riprodhues. Ne punojmë për të promovuar sjellje të shëndetshme për të parandaluar të rinjtë nga radikalizmi dhe ekstremizmi i dhunshëm, dhe SIT kryen kërkime në fushat socio-ekonomike. Ne ofrojmë hulumtime dhe informacione përkatëse për akterë të ndryshëm në Kosovë.

Për më shumë informacion rreth SIT, vizitoni: www.sit-ks.org

Detyrat dhe përgjegjësitë:

- Realizimi i 4 muraleve në komunat e Fushë Kosovës, Kamenicës, Mitrovicës së Jugut, dhe Mitrovicës së Veriut në kuadër të projektit “Dialog për Paqe”.
- Realizimi i 4 punëtorive/trajnimeve me pjesëmarrësit e projektit “Dialog për Paqe” nga secila komunë mbi metodat e realizimit të muraleve.
- Asistencë në ideim të muraleve.

Dërgoni dokumente e mëposhtme në: apliko@sit-ks.org

- CV jo më shumë se dy faqe;

- Portfolio të shkurtër.

Afati i fundit për aplikim: **29 prill 2022**. Kohëzgjatja e kontratës është për **4 muaj!**

Pozita: Gjysmë orari

Vetëm kandidatët e përzgjedhur në listën e ngushtë do të kontaktohen!

